



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Tabela paraprake e vlerësimit të fakteve/vlerësimit nga monitorimi

Datë: 06.03.2019

Numri i seancës për këtë çështje: 1 (një)

Ky monitorim u realizua në kuadër të projektit nr.2 "Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut"- projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqipëri (OSFA) dhe zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH).

A. Informacioni bazë

Institucioni dhe tema:	Institucioni: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK). Objekti: Procesi për rivlerësimin kalimtar të subjektit, z. Arqilea Koca
Emri i subjektit të rivlerësimit	z. Arqilea Koca
Pozicioni i punës/ qyteti nëse nuk është Tirana	Prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme, Tiranë
A u shty seanca dhe a ishte e arsyeshme kjo shtyrje?	Nuk pati shtyrje të seancës dëgjimore dhe as shkak ligjor.
A u shpall vendimi apo jo (Ju lutem paraqisni arsyet në mënyrë të përmbledhur)	Në fund të seancës dëgjimore trupit gjyqësor u tërhoq për marrjen e vendimit dhe shtyu seancën në datën 08.03.2019, ora 10:00.

B. Aktorët që marrin pjesë në proces/seanca

Trupa gjyqësore (emrat)	Kryesues: Etleda Ciftja, Relator: Furdes Shuli, Anëtar: Roland Ilia.
Monitoruesit ndërkombëtarë (emrat)	Përfaqësuesi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (OMN)
Mbrojtje me avokat apo mbrojtje personalisht (specifikoni)	Personalisht
Monitoruesi/ja i/e KSHH:	Amilda Celami
Anëtarë të tjerë të publikut të pranishëm?	Media, përfaqësues të organizatave të shoqërive civile, familjarë të subjektit të rivlerësimit, qytetarë të interesuar. Numri total i të pranishmëve variante 15-20 persona.
Media e pranishme:	Gazetarë të mediave ishin të pranishëm duke respektuar rregulloren e KPK-së.

C. A vendosi institucioni i vettingut ta bëjë vettingun për të tre kriteret apo bazuar vetëm në një apo dy prej tyre?	Po/Jo	Nëse po, si u justifikua ai?	Nëse po, si ka reaguar subjekti ndaj kësaj ?
	KPK e bazoi gjykimin mbi tre kriteret (Vlerësimi i pasurisë , Kontrolli i Figurës, Vlerësimi i aftësive profesionale)		

D. Përmbajtja e çështjes (Vlerësimi i kriterëve)	Argumenti	Kush e ka dhënë argumentin	A u diskutua? Prova? A u kalua barra e provës ?
--	-----------	----------------------------	---

D1. Pasuria

Raporti i ILDKPKI-së : Deklarim i saktë, ka burime të ligjshme financiare, subjekti nuk ka kryer fshehje të pasurisë, nuk ka bërë deklaram të rremë, subjekti nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit.	Raporti nga ILDKPKI	Lidhur me gjykimin e kriterit të pasurisë, kontrollit të figurës, aftësive profesionale, relatori i çështjes, pohoi se hetimi ishte bazuar në të dhënat e ardhura nga ILDKPKI, DSIK, Grupi i Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme, hetimi administrativ i KPK-së, të dhënat e marra nga institucionet publike dhe nga shpjegimet e bëra nga vetë subjekti i rivlerësimit. Në bazë të rezultateve të hetimit, subjektit të rivlerësimit i ishte kërkuar të japë shpjegime/prova.	
Kriteri i pasurisë: 1. Truall me sip. 880m2 në Linzë, Tiranë blerë nga shtetasi F.A i cili nuk ka zotëruar dokumente pronësie në atë kohë. Kontrata e shitjes është bërë në vitin 2000 ndërmjet shtetasit F.A dhe subjektit të rivlerësimit. Vlera: 415 mijë lekë. Në vitin 2005, z. Koca ka shkëmbyer pronësinë e këtij trualli me kontratë këmbimi me Shoq "R", nga e cila do i kalohej 25% e vlerës së saj. Në vitin 2007 është lidhur kontrata e sipërmarrjes ndërsa në vitin 2014 me anë të aktit të këmbimit janë përcaktuar 8 pasuri (apartamente) të përfituara nga Shoq "R". Në vitin 2009 apartamentet janë marrë në dorëzim nga subjekti i rivlerësimit. 8 apartamentet nuk janë deklaruar në deklaratat periodike. Arsyja: subjekti i rivlerësimit është justifikuar duke pohuar se nuk ka qenë pronar juridik. z. Koca ka deklaruar vetëm shitjen e 3 apartamenteve 2. AP. Banimi në Lukovë, Sarandë, blerë në vitin 2011. KPK: në deklaratat e viteve 2011, 2013, 2015 nuk është deklaruar burimi i krijimit të kësaj pasurie, por sipas KPK subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie. 3. Tokë bujqësore dhe themele të ngritura në Voskopojë, Korçë. Në deklaratat e viteve 2011, 2013 dhe 2015 nuk është deklaruar burimi i krijimit. KPK në hetimin e saj ka konkluduar se Z. Koca ka pasur burime të ligjshme për blerjen e kësaj toke. 4. Kredi e butë, në vlerën 5 milion, marrë me statusin si i pastrehë, në vitin 2000. 5. Automjet Wolsvagen. Vlera 550 mijë lekë. Burimi : Kredi nga Raiffeisen bank. 6. Automjet Honda. Vlera 1 milion e 300 mijë lekë, blerë në vitin 2017. Nuk është pasqyruar burimi. 7. AP. Banimi në Korçë , përfituar me kontratë privatizimi në vitin 2000, rreth 4 muaj pasi ka përfituar kredinë e butë. Subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë pasuri në Deklaratën e vitin 2003 por në Deklaratën Vetting. 8. AP. Banimi në Sarandë, 92m2, pjesa takuese ¼, përfituar në vitin 1994 nga privatizimi i banesave shtetërore. Kjo pasuri nuk është deklaruar.	Relatori i çështjes		
	Mbrojtja		

	<p>Në lidhje me gjetjet e pasurisë nga hetimi i thelluar i KPK-së subjekti i rivlerësimit pohoi lidhur me mos deklarimin e ndërtimit provizor në Linzë, Tiranë, duke mos e deklaruar si ndërtim të mirëfilltë dhe se nuk e ka parë si të arsyeshme deklarimin e saj. Subjekti pohoi se nuk ka pasur qëllim fshehjen e kësaj pasurie. Mos deklarimi i apartamente të përfituara nga marrëveshja me Shoq "R", z. Koca dha arsytimin se ishte bërë pronar de jure i tyre shumë vonë, ndaj nuk i ka deklaruar që në fillim. Njëri nga apartamentet e përfituara i është lënë në përdorim vjehërrës, pasi kjo ka shërbyer edhe për mirëmbajtjen e tij. Tjetri i është lënë administratorit të pallatit, me qëllim që ai të kujdesej për apartamente e tjera. Për disa pasuri nuk ka pasur deklarim të ardhurash pasi duke pasur disa burime të ardhurash e konsideroi si të pamundur identifikimin e tyre. Lidhur me apartamentin e banimit në Korçë përfituar nga statusi si i pastrehë, theksoi se kërkesën e kishte bërë para se të përfitonte kredinë e butë. Kërkesa si i pastrehë është bërë në vitet e 1992-1993. Pyetjes së kryesueses së trupës se pasuritë e listuar më lartë janë shumë për një funksionar shteti, dhe sesi një person me njohuri juridike ka paguar një person që nuk dihej nëse ishte pronar apo jo? Subjekti i rivlerësimit pohoi se bazuar në kontekstin social-psikologjik të kohës besimi dhe njohja ishin funksionale në të kohë. Risku ishte marrë përsipër nga vetë z. Koca.</p>	Subjekti	
D2. Figura /Kontaktet me krimin e organizuar	Raporti i DSIK ka konkluduar se: për subjektin e rivlerësimit nuk ka pasur dyshime për pastërtinë e figurës, është i saktë në përputhje më ligjin.	Ankesa nga publiku ONM Të dhëna nga raportet e DSIK Relatori Mbrojtja Subjekti Ankesa nga publiku ONM	
D3. Vlerësimi i aftësive profesionale dhe etikës	<p>Raporti Grupit të Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme citon që subjekti i rivlerësimit ka aftësi profesionale, organizative si dhe ka treguar nivel të lartë të vlerave dhe angazhim profesional duke e konsideruar si të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.</p> <p>z. Koca theksoi se kishte një karrierë 30 vjeçare si prokuror duke ndërmarrë detyra të rëndësishme, gjithmonë në përpjekje për të ruajtur integritetin moral dhe profesional.</p>	Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme Relatori ONM Subjekti	
E. Konkluzione dhe komente të monitoruesit të KSHH (Vlerësimi paraprak i monitoruesit të KSHH për aspektet e procesit të drejtë ligjor (publiciteti, etika e organeve të vettingut dhe përfaqësuesit të OMN , si e vlerësoni hetimin administrativ, të drejtat e mbrojtjes së subjektit, barazia e mjeteve ligjore, parimi i kontradiktoritetit, koha e arsyeshme, e drejta për të paraqitur prova dhe e drejta për tu dëgjuar, etj.)	<p>Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit z. Aqilea Koca, prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme, zgjati rreth 1 orë, duke respektuar kriteret për një gjykim të drejtë. Pati kontestime, pyetje nga kryesuesja e trupit gjyqës, përfaqësuesi i ONM-së, kundërshtime nga subjekti i rivlerësimit. Të gjitha pyetjet drejtuar subjektit të rivlerësimit kishin në pikëpyetje kriterin e pasurisë. Gjatë shqyrtimit të seancës dëgjimore u trajtuan tre kriteret e gjykimit të procesit të rivlerësimit (Vlerësimi i pasurisë, Kontrolli i figurës dhe aftësive profesionale). Problematik u paraqit vetëm kriteri i pasurisë, pasi dy kriteret e tjera arritën në vlerësim të subjektit të rivlerësimit. z. Koca pohoi se ishte njohur dhe kishte marrë në dorëzim materialet e dosjes dhe i ishte kaluar barra e provës. Relatorja e çështjes pohoi se ndaj subjektit të rivlerësimit nuk kishte pasur asnjë ankesë. Trupi gjyqës në asnjë moment nuk shkeli rregullat e etikës, profesionalizmit dhe nuk u vërejtën probleme të kësaj natyre. Subjekti i rivlerësimit kishte zgjedhur të mos kishte mbrojtës ligjor. Nuk u konstatua asnjë shkelje, paragjykim apo presione të ndryshme gjatë seancës. Përmasat e sallës në pallatin e Koncerteve (ish pallati i Kongreseve) garantonte respektimin e plotë të standardeve të një seance publike.</p>		